

## THE TREATMENT OF DIRECT AND INDIRECT OPPOSITION (ACCUSATIVE OBJECT) WITHOUT PREPOSITIONS WITH STUDENTS OF THE LOWER CYCLE

**Sindorela Doli-Kryeziu**

Universiteti “Fehmi Agani” Gjakovë, Kosovo, [sindorela.doli.kryeziu@uni-gjk.org](mailto:sindorela.doli.kryeziu@uni-gjk.org)

**Abstract:** Since, the direct object and the indirect object without preposition are second limbs of the sentence, therefore as such these in the Albanian language belong to the field of syntax. Through this thesis topic entitled "The direct object and the indirect object without preposition", as well as research on it, we tried to present the problem, which we encountered throughout my experience as a student and later as an intern student during practical work with primary school students. Among other things, we have noticed that the field of syntax, more specifically the knowledge about the direct object and the indirect object without preposition are not "fed" enough in the minds of students and this ignorance of students' mental chemistry can normally bring a dissatisfied result and disturbing for linguists, teachers, students and the Albanian language itself. We have decided to research this issue, selecting as object of research the three schools that are considered the best schools in the municipality of Gjakova. From these three schools we have selected three classes, which we have physically distributed the prepared questionnaire of twelve questions, related to the topic about the direct object and the indirect object without preposition. The questionnaire was answered by fifth grade elementary students. Findings from this research, related to the above topic, confirm the hypotheses presented, where the results obtained from the questionnaire are factual, which clearly show that students have processed knowledge about objects more mechanically than logically. According to these findings we can affirm a conclusion, which reflects the real situation, which has come as a result of inadequate teacher planning, where more attention is paid to the formal attendance of the curriculum, leaving aside the construction of students' knowledge.

**Keywords:** syntax, object, the direct object and the indirect object without preposition student.

## TRAJTIMI I KUNDRINORIT TË DREJTË DHE ATIJ TË ZHDREJTË PA PARAFJALË ME NXËNËSIT E CIKLIT TË ULËT

**Sindorela Doli-Kryeziu**

Universiteti “Fehmi Agani” Gjakovë, Kosovë, [sindorela.doli.kryeziu@uni-gjk.org](mailto:sindorela.doli.kryeziu@uni-gjk.org)

**Abstrakti:** Meqenëse, kundrinori i drejtë dhe kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë janë gjymtyrë të dyta të fjalisë, andaj si të tilla këto në gjuhën shqipe i përkasin fushës së sintaksës. Përmes kësaj teme që do të trajtojmë si dhe hulumtimit rreth saj, jemi munduar që të paraqesim problematikën, të cilën e kemi ndeshur përgjatë përvojës së punës praktike të studentëve me nxënësit e ciklit fillor. Ndër të tjera kemi vërejtur që fusha e sintaksës, më konkretisht njohuritë rreth kundrinorit të drejtë dhe kundrinorit të zhdrejtë pa parafjalë nuk janë “ushqyer” sa duhet në mendjen e nxënësve dhe kjo mosnjohje e kimisë mendore të nxënësve, normalisht që mund të sjellë një rezultat të pakënaqshëm dhe shqetësues për gjuhëtarët, për mësuesit, për nxënësit dhe për vetë gjuhën shqipe. Këtë çështje kemi vendosur ta hulumtojmë, duke përzgjedhur si objekt hulumtimi tri shkollat që konsiderohen si shkollat më të mira në komunën e Gjakovës. Nga këto tri shkolla kemi përzgjedhur tri klasa, të cilave ua kemi shpërndarë fizikisht pyetësorin e përgatitur prej dymbëdhjetë pyetjesh, të lidhur me temën rreth kundrinorit të drejtë dhe kundrinorit të zhdrejtë pa parafjalë. Pyetësorit i janë përgjigjur nxënësit filloristë të klasëve të pesta. Gjetjet nga ky hulumtim, lidhur me temën e sipërpërmendur, vërtetojnë hipotezat e parashtruara, ku faktike janë rezultatet e nxjerra nga pyetësori, të cilat tregojnë qartë, se nxënësit, njohuritë rreth kundrinorëve i kanë përpunuar më shumë në mënyrë mekanike sesa logjike. Sipas këtyre gjetjeve mund të pohojmë një përfundim, i cili pasqyron gjendjen reale, që ka ardhur si rezultat i planifikimit joadekuat të mësimdhënësive, ku më tepër i është kushtuar rëndësi ndjekjes formale të planprogramit mësimor, duke lënë anash ndërtimin e njohurive të nxënësve.

**Fjalët kyçe:** sintaksa, kundrina, kundrinori i drejtë, kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë, nxënësi.

### 1. HYRJE

Duke pasur parasysh sa e rëndësishme është gjuha amtare, andaj edhe gjuha shqipe meriton të respektohet si gjuhë së bashku me rregullat e saj. Një kujdes të veçantë të respektimit të rregullave gjuhësore, mund të themi se nuk e kemi hasur gjatë kryerjes së praktikës pedagogjike nëpër shkolla, duke mos lënë anash edhe shumë raste gjatë studimeve.

“Ikja” nga respektimi i rregullave të gjuhës amtare shqipe, duke i lënë pas dore kategoritë përbërëse të standardit të saj, është pothuajse një pikë problemore shqetësuese dhe kjo medoemos duhet prekur “ndërgjegjen” e të gjitha hallkave zingjirore që merren me arsimimin e gjeneratave në vend. Trajtimi i temës rreth *kundrinorit të drejtë* dhe *kundrinorit të zhdrejtë pa parafjalë* është një çështje delikate, e cila kërkon më shumë gjurmime, si dhe përdorim të metodave e teknikave më të avancuara në mënyrë që rezultatet e nxjerra të sjellin novacione teknikash që do të shërbejnë që të mësuarit e gramatikës së gjuhës të mund të “ruhet” më mirë në kujtesën afatgjatë të nxënësve.

Si objekt hulumtimi kemi caktuar tri shkolla fillore të Komunës së Gjakovës dhe nga këto tri shkolla fillore kemi përzgjedhur tri paralele të pesta. Pyetësi është formuluar për të hulumtuar njohuritë e nxënësve të klasëve të pesta rreth temës mësimore për *kundrinorin e drejtë* dhe *kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë*. Grupmoshat e pjesëmarrësve kanë qenë të moshës 10-11 vjeç, kugjithsej pyetësit iu përgjigjën 70 nxënës pjesëmarrës.

Gjithmonë, duke u bazuar në *Kundrinorin, i cili* është gjymtyrë e dytë e fjalisë me lidhje drejtimi, që vihet në marrëdhënie objektore me gjymtyrën prej së cilës varet. (Beci, 2016.)

Në planin sintaksor, sipas kumtimit e sipas formës së shprehjes, dallohen kundrina e drejtë dhe kundrina e zhdrejtë.

**Kundrinori i drejtë** tregon personin apo sendin mbi të cilin bie veprimi i shprehur nga folja. Atë e dallojmë duke përdorur pyetjet: *kë?*, *cilin?*, *çfarë?*, që bëhen për të qartësuar veprimin që shpreh folja. (Xhevat Sylja, Leximi 4, Libri shkollor., 2006)

1. Rrezet e hënës ndriçuan majën e malit.

2. Dikush lëshoi një klithmë.

3. Hëna e humbi shkëlqimin e saj.

4. Vajza e vogël lan pjatën (Demiri, 2020)

Grupet e fjalëve *majën e malit, një klithmë, shkëlqimin e saj*, që u përgjigjen pyetjeve, *çfarë, kë*, drejtuar foljes, janë kundrinorë të drejtë.

*Kundrinori i drejtë është një emër, një përemër, ose një emër dhe një përcaktor në rasën kallëzore pa parafjalë.* (Bahri Beci, 2007)

**Kundrinori i zhdrejtë**

Për ta dalluar kundrinorin e zhdrejtë në fjali, përdorim pyetjet *kujt?*, *cilit?*, *cilës?* etj. Për shembull, në fjalinë:

*Dritareve u janë thyer xhamat.*

Përmes pyetjes *kujt* na del se kundrinori i zhdrejtë është emri *dritareve.*, ku mbi të bie veprimi i foljes *u janë thyer.* (Xhevat Sylja, Leximi 5, Libri shkollor, 2018)

\*Sugjerim: Në leximin e klasës V-të, kundrinori i zhdrejtë duhet të paraqitet me të gjitha format e tij (nënkuptoj si kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë dhe me parafjalë).

Kundrinori i zhdrejtë paraqitet me dy forma:

a) kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë dhe

b) kundrinori i zhdrejtë me parafjalë. (Çeliku.M., Domi.M., Floqi. S., Mansaku. S., Përnaska. R. , 2002)

Në planin sintaksor, sipas kumtimit e sipas formës së shprehjes, dallohen kundrina e drejtë dhe kundrina e zhdrejtë.

Kundrinori i zhdrejtë paraqitet me dy forma:

c) kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë dhe

d) kundrinori i zhdrejtë me parafjalë. (Çeliku.M., Domi.M., Floqi. S., Mansaku. S., Përnaska. R. etj, 2002)

Gjithashtu, nuk marrin kundrinorë të drejtë edhe disa folje kalimtare, kur përdoren si jokalimtare; këto folje shprehin thjesht veprim të kryefjalës si një veprim të përgjithshëm, si:

▪ Ai *punon* shumë.

▪ Disa *punojnë* në sektorin privat.

▪ Fëmijët e klasës së parë për tre muaj arrijnë të *shkruajnë mirë.* (Mehmet Çeliku, 2012)

Shembuj tjerë me kundrinorë:

• Mos harro *artikullin!*

E afërt me këtë kundrinë është edhe **kundrina tautologjike** (Thomai.J., Samara.M., Haxhillazi.P., Shehu. H., Feka. Th., Memisha.V., Goga.A., , 2006) e ndërtuar me folje jokalimtare. Në ligjërimin popullor është shumë i kufizuar numri i foljeve jokalimtare që mund të marrin një të tillë kundrinë (si: fle, jetoj, flas, luftoj, ëndërroj e ndonjë tjetër). Në gjuhën e letërsisë artistike herë-herë përdoren edhe folje të tjera.

• Para se të futej brenda, zgjidhi *qenin.*

• Ai hapi *çantën.*

• Çdo javë i shkruan letër *familjes.* (Çeliku, 2016)

• Gjuha shqipe për të huajt dhe shqiptarët jashtë *Atdhut* (Shkurtaj, Gjovali., Hysa, Enver, 2022)

• Përgatitemi për *provimin* e vlerësimit të njohurive të arsimit fillor, (Avdiko, Afërdiya., Shuraja, Fredrik., 2022)

- E mbajti *fjalën* e dhënë. (Ministria e Arsmit, 2020)

## 2. MATERIALET DHE METODOLOGJIA

Metodologjia e punimit rrjedh nga njohuritë bazike të nxjerra nga literaturat profesionale të studiuesve të gjuhës shqipe. Metodatat që janë përdorur për përpunimin e të dhënave janë ato të: metodës sasiore (kuantitative) dhe analizës së të dhënave. Nga këto metoda janë mbledhur dhe përpunuar të dhëna, të cilat janë formuluar duke u bazuar në nivelin e pjesëmarrësve që do të marrin pjesë në hulumtim, të cilat më pas janë interpretuar e strukturuar duke i paraqitur më tej edhe në mënyrë grafike. Si instrument për mbledhjen e këtyre të dhënave nga hulumtimi, kemi përdorur pyetësin prej gjashtë pyetjeve, ku më pastaj edhe janë dhënë rezultatet e kompletuara. Instrumenti i cili na ka ndihmuar që të realizojmë këtë hulumtim ka qenë pyetësi i cili e kemi përpiluar posaqërisht për këtë çështje, pasi që bazuar në njohuritë e nxënësve vjen parasysh edhe puna e mësimdhënësve, si kusht për arritjet dhe përfitimet akademike të nxënësve në procesin mësimor.

## 3. REZULTATET E PUNIMIT

Gjatë punës së kryer rreth këtij hulumtimi janë nxjerrë rezultate, të cilat i vërtetojnë hipotezat e ngritura e të planifikuara.

- Metodologjia e mësimdhënies së mësuesve të klasës së V-të nuk është në përputhje me aftësitë e të nxënësve të nxënësve.
- Metodologjia e përdorur për njësitë: *“Kundrinori i drejtë dhe kundrinori i zhdrejtë pa paraafalë”*, bën që nxënësit të mësojnë në mënyrë mekanike këto dy njësi sintaksore.

Rezultatet e nxjerra nga pyetësit:

Në këtë pyetësor janë përfshirë të dy gjinitë dhe të dhënat janë paraqitur grafikisht me përqindje për secilën pyetje.




Figura 1. Të dhënat për gjininë e pjesëmarrësve.




Figura 2. Të dhënat e moshës së pjesëmarrësve.




Figura 3. Të dhënat e nxjerra nga nxënësit rreth njohurive për kundrinorit të drejtë.




Figura 4. Të dhënat nga nxënësit për kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë.




Figura 5. Të dhënat nga nxënësit rreth pyetjeve kundrinorit të drejtë.



Figura 6. Të dhënat nga nxënëset rreth pyetjeve për gjetjen e kundrinorit të drejtë.




Figura 7. Të dhënat nga nxënësit për të zhdrejtë pa parafjalë.




Figura 8. Të dhënat nga nxënësit për rasën e kundrinorit të drejtë.



Figura 9. Të dhënat nga nxënësit rreth shembujve për kundrinorin e drejtë.



Figura 10. Të dhënat nga nxënësit rreth shembujve për kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë.



Figura 11. Të dhënat nga nxënësit rreth kuptimit të temës nga shpjegimi i mësueses.



Figura 12. Të dhënat nga nxënësit rreth pëlqimeve për temën rreth kundrinorit të drejtë dhe të zhdrejtë pa parafjalë.

#### 4. DISKUTIME

Mund të them se pas kryesjes së hulumtimit gjetjet tona kanë domethënie të tillë që:

- ✓ Për arsimin në Kosovë gjetjet janë pasqyrë e vlerësimit të testeve ndërkombëtare si p.sh. testi PISA.

- ✓ Për mësimdhënësit, gjetjet janë më shumë si përpjekje kuptimore, përfshirje e ideve kreative dhe gërshetim i ngjarjeve me përditshmërinë. Qëndrimi larg zhargoneve të dekadave bën që nxënësit të kenë simpati ndaj librave dhe mësimi.
- ✓ Për nxënësit, ajo çfarë mësojnë brenda 45 minutave të një ore mësimore është  $\frac{1}{4}$  e “brumit” të asaj njësie, ndaj studimi i pjesëve të tjera është përmbushje e misionit të përgatitjes së “brumit” me gjithë përbërësit e tij.

## 5. PËRFUNDIME

Pas përfundimit të këtij kemi arritur në disa konkluzione:

Së pari, është me shumë rëndësi të theksojmë peshën e rëndë që mban mbi supë një mësimdhënës/e dhe përgjegjësinë që ka puna e tyre. Është shumë me rëndësi të vlerësohet rëndësia që ka lidhja e anës teorike me atë praktike, pastaj përsëritja dhe njohja e gjërave të rëndësishme ndër vite, pasi jo më kot përsëritja konsiderohet si “nëna e dijes”. Puna e mësuesit duhet të jetë mjeshtëri, në mënyrë që nga kjo mjeshtëri të krijohen mendje mjeshtërore te nxënësit, gjë e cila nuk është dëshmuar gjatë këtij hulumtimi.

Shpjegimi i temave mësimore në tabelë ose në projektor dhe leximi i tyre pa syrin kritik të të dyja palëve (mësues-nxënës) sjellë njohuri mekanike dhe jo logjike të të mësuarit. Mendojmë që dhënia e udhëzimeve të duhura për rregullat e ndërtimit të kundrinorit të drejtë dhe të zhdrejtë pa parafjalë (mënyra auditive), paraqitja e tyre dhe analizimi i tyre në tabelë ose projektor (mënyra vizuale) dhe ndërlidhja e tyre me shembuj nga jeta e përditshme, pastaj krijimi i shembujve nga vetë nxënësit si dhe të shkruarit e tyre në fletore (si përpunim përfundimtar) do të hidhte hapat e parë drejt njohjes së shumë leksioneve.

Gjithashtu, mendojmë që rol të veçantë luan edhe dizajnimi i librave më konkretisht i njësive mësimore me ilustrime të ndryshme, duke i bërë ata më tërheqës për nxënësit, pasi mendojmë që, një dizajnim i pandryshueshëm ndër vite bën që nxënësit “të ftohen” nga leximi dhe nuk iu lë atyre hapësirë për krijim dhe eksplorim të gjërave që duhen mësuar.

## REFERENCA

Avdiko, A., & Shuraja, F. (2022). Gjuha Shqipe 5: Përgatitemi për provimin e vlerësimit të njohurive të arsimit fillor, . Tirana: Redona.

Bahri B. (2007). Gjuha shqipe 5. Pejë: Dukagjini.

Beci, B. (2016.). Gjuha shqipe 4. Pejë: Dukagjini.

Çeliku, M. (2016). Tekst ushtrimesh të sintaksës së shqipes standarde. Tiranë: ILAR.

Çeliku, M., Domi, M., Floqi, S., Mansaku, S., & Përnaska, R. (2002). Gramatika e gjuhës shqipe. Tiranë.

Çeliku, M., Domi, M., Floqi, S., Mansaku, S., & Përnaska, R. etj. (2002). Gramatika e gjuhës shqipe. Tiranë.

Çeliku, M. (2012). Sintaksë e gjuhës shqipe. Tiranë.

Demiri, E. (2020, Maj 11). Gjuhe shqipe 5. Kundrinori i drejte. Gjetur në

[https://www.youtube.com/watch?v=a8MSTq4I7jc&t=105s&ab\\_channel=EmiljanaDemiri](https://www.youtube.com/watch?v=a8MSTq4I7jc&t=105s&ab_channel=EmiljanaDemiri)

Ministria e Arsimit, S. d. (2020, tetor 11). Gjuhë shqipe 7 - Kundrinorët. Gjetur në

[https://www.youtube.com/watch?v=gaiJQ3ONT4M&ab\\_channel=MinistriaeArsimit%2CSportitdheRinis%2C3%AB](https://www.youtube.com/watch?v=gaiJQ3ONT4M&ab_channel=MinistriaeArsimit%2CSportitdheRinis%2C3%AB)

Shkurtaç, G., & Hysa, E. (2022). Gjuha shqipe per te huajt dhe shqiptaret jashte Atdheut,. Tirana: Toena.

Thomai, J., Samara, M., Haxhillazi, P., Shehu, H., Feka, Th., Memisha, V., & Goga, A. (2006). Fjalor i gjuhës shqipe. Tiranë.

Xhevat, S.. (2006). Leximi 4, Libri shkollor,. Prishtinë.

Xhevat, S.. (2018). Leximi 5, Libri shkollor. Prishtinë.